

VENDIM
Nr. 420, datë 27.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 575, DATË 10.7.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 8, 12/1, pika 4, 16, pika 3, 25, pika 5, e 26, pika 9, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtjen e këtyre rregullave, emërtimi “Njësia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat” zëvendësohet me “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)” dhe “Ministria e Financave” zëvendësohet me “ministra përgjegjëse për financat”.

2. Pikat 4 dhe 5, të nenit 3, ndryshohen si më poshtë vijon:

“4. Komisioni i koncesionit/PPP përgatit një raport përmbledhës paraprak, i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë e të përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit. Ai duhet të përmbajë, të paktën,;

- a) përshkrimin e situatës aktuale, duke përfshirë të metat dhe mundësitë, një pasqyrë të tregut;
- b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;
- c) përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- ç) legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit;
- d) në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërisht ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private;

dh) në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërisht një subjekt privat;

- e) përfitimet strategjike dhe operationale që priten nga projekti;
- ë) bashkërendimin me politikat e përgjithshme të investimeve sektoriale apo rajonale;
- f) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;
- g) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;
- gj) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion;
- h) alternativat e alokimit të risqeve kryesore të mundshme, ndërmjet palës publike dhe subjektit privat;

i) konkluzionet e rekomandimet, duke përfshirë modelet e zbatueshme/të përshtatshme të partneritetit publik privat.

5. Autoriteti kontraktues, bazuar në raportin përmbledhës paraprak të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, vendos:

a) shtyrjen ose refuzimin e plotë të zbatimit të projektit. Në rastin e refuzimit, bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit për mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të

konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm ose nuk është më pjesë e prioritetëve të institucionit;

b) vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit.”.

3. Pika 3, e nenit 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Sa herë që jepen punime civile për t'u realizuar, analiza teknike duhet të përmbajë pjesët përkatëse të skicuara, si më poshtë vijon:

a) planin e vendndodhjes së zonës;

b) planin e përgjithshëm;

c) planet e përgjithshme dhe seksionet e arkitekturës, rezistencës, instalimeve;

ç) planet e veçanta, profilet gjatësore, profilet tërthore, sipas kërkesës.”.

4. Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Rezultatet e studimit të fizibilitetit përmbledhen në raportin përmbledhës, i cili në thelb duhet të tregojë se:

a) projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat e politikave të autoritetit kontraktues;

b) projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;

c) projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;

ç) alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti, nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP, është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Projekti që përmbush të gjitha kushtet e pikës 1, të këtij neni, më tej paraqitet për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat, e cila e vlerëson dhe miraton paraprakisht projektin e koncesionit/(PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.”.

5. Shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 10, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) propozimi të lidhet me një projekt në njërin prej sektorëve që parashikohen në nenin 4, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror;”.

6. Shkronja “a”, e pikës 3, të nenit 12, shfuqizohet.

7. Pika 5, e nenit 13, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Autoriteti kontraktues i komunikon propozuesit nëse projekti mund të zbatohet apo jo, në bazë të rezultateve përfundimtare të studimit të fizibilitetit. Pranimi përfundimtar i projektit duhet të miratohet nga ministria përgjegjëse për financat, e cila vlerëson dhe miraton paraprakisht projektin e koncesionit/(PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.”.

8. Neni 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 15

Shuma e kompensimit

1. Kur procedura e dhënies së koncesionit/PPP, e nisur mbi një propozim të pakërkuar, finalizohet me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit vetëm nëse ai ka marrë pjesë në garë por nuk është shpallur fitues.

2. Shuma e kompensimit për shpenzimet e kryera nga propozuesi për përgatitjen e studimit të

fizibilitetit llogaritet mbi bazën e faturave që vërtetojnë kryerje të shpenzimeve, por nuk mund të jetë më e lartë se 1% e vlerës së investimit.

3. Vlera e përcaktuar e kompensimit publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe paguhet nga ofertuesi i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës.”.

9. Titulli i kreut IV ndryshohet si më poshtë vijon:

“KREU IV PROCEDURA DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN DHE MIRATIMIN E PROJEKTEVE TË KONCESIONEVE/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT NË MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR FINANCAT”.

10. Neni 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 17

Miratimi para shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/PPP

1. Ministria përgjegjëse për financat, referuar nenit 10, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale, pavarësisht nga modeli i parashikuar i koncesionit /PPP dhe mënyra në të cilën ato janë nisur, propozim i kërkuar apo i pakërkuar. Nëse do të ketë ndryshime të mëtejshme në studimin e fizibilitetit, pasi është paraqitur fillimisht për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat, autoritetet kontraktore duhet ta paraqesin sërish për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat për të verifikuar implikimet e mundshme fiskale.

2. Autoriteti kontraktues kërkon miratimin sipas pikës 1, të këtij neni, përpara shpalljes së procedurës për dhënien me koncesion/PPP të një kontrate. Në rast se brenda 2 (dy) viteve nga marrja e miratimit nga ministria përgjegjëse për financat nuk është shpallur operatori fitues, atëherë autoriteti kontraktues do të dërgojë studimin e fizibilitetit të rishikuar edhe një herë për miratim pranë ministrisë përgjegjëse për financat, përpara shpalljes së procedurës për dhënien me koncesion/PPP të një kontrate.

3. Përveç miratimit të parashikuar në pikat më sipër edhe projektet e koncesioneve/PPP, që pësojnë ndryshime të kontratës apo transferim të saj në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, duhet të dorëzohen pranë ministrisë përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson dhe miraton paraprakisht nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.”.

11. Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

a) titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet “Procedurat për vlerësim dhe miratim”.

b) pikat 1 dhe 3 ndryshohen si më poshtë vijon:

“1. Kërkesa për vlerësim dhe miratim në ministrinë përgjegjëse për financat paraqitet në formë të shkruar dhe shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 19, të këtyre rregullave.

3. Ministria e përgjegjëse për financat miraton ose refuzon projektin jo më vonë se 40 (dyzet) ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, nëse autoriteti kontraktues nuk ka marrë ndonjë kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit. Në rast se autoriteti kontraktues ka marrë një kërkesë të tillë, atëherë afati zgjatet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita kur është marrë informacioni.”.

c) Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

12. Neni 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 19

Dokumentacioni

Kërkesa dhe studimi i fizibilitetit të projektit që paraqiten për miratim në ministrinë

përgjegjëse për financat, shoqërohen me:

- a) projektkontratën;
 - b) një raport të përmbledhur final të studimit të fizibilitetit, i cili duhet të përmbajë:
 - i. pasqyrën e flukseve të arkës;
 - ii. analizën e risqeve që mund të impaktojnë projektin, e cila duhet të përfshijë një vlerësim cilësor dhe sasior në rast të materializimit të këtyre risqeve;
 - iii. dokumentin që projekti është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm (PBA);
- Dokumentacioni i përcaktuar nga ky nen dorëzohet një kopje në formë të shkruar dhe një kopje në formë elektronike (CD apo forma të ngjashme me të).

Pas marrjes së dokumentacionit të përcaktuar nga ky nen, ministria përgjegjëse për financat verifikon dokumentacionin dhe, nëse vlerësohet i paplotë, kërkon plotësimin e tij.”.

13. Pas nenit 19 shtohet neni 19/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Miratimi i kontratës

1. Pas negociimit të kontratës me operatorin e shpallur fitues dhe përpara nënshkrimit të saj, autoriteti kontraktues e dërgon projektkontratën për vlerësim përfundimtar, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, në ministrinë përgjegjëse për financat.

2. Ministria përgjegjëse për financat jep vlerësimin përfundimtar mbi kontratën e koncesionit/PPP, jo më vonë se 40 (dyzet) ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, nëse autoriteti kontraktues nuk ka marrë ndonjë kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit. Në rast se autoriteti kontraktues ka marrë një kërkesë të tillë, atëherë afati zgjatet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita kur është marrë informacioni.

3. Kontratat e koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që marrin përsipër risqe fiskale, pas nënshkrimit nga palët dhe vetëm pas marrjes së vlerësimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për financat, dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave.

4. Me “risqe fiskale” nënkuptohet mundësia e deviacioneve të treguesve fiskalë të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, si pasojë e materializimit të risqeve të parashikuara në një kontratë koncesionare apo PPP.”.

14. Pas pikës 2, të nenit 20, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Gjatë procedurës së analizës, ministria përgjegjëse për financat bazohet në dokumentacionin e përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 19, të këtij vendimi.”.

15. Neni 21 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 21

Vendimarrja e ministrisë përgjegjëse për financat

1. Ministria përgjegjëse për financat miraton projektin, nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare është e përballueshme dhe e qëndrueshme, si dhe nëse risqet e marra përsipër nga autoriteti kontraktues nuk cenojnë përballueshmërinë dhe qëndrueshmërinë fiskale.

2. Ministria përgjegjëse për financat refuzon projektin, nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare nuk është e përballueshme dhe/ose e qëndrueshme ose mundësia e risqeve të ndërmarra nga autoriteti kontraktues në projekt janë të tilla që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe/ose qëndrueshmërinë fiskale.

3. Projektet e refuzuara mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të nevojshme dhe të paraqiten përsëri për miratim në ministrinë përgjegjëse për financat duke iu nënshtuar procedurave nga fillimi.”.

16. Në nenin 23 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Çdo ndryshim ose transferim i kontratës së koncesionit/PPP, i ndërmarrë në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, duhet të dorëzohet në ministrinë përgjegjëse për financat për miratim paraprak, e cila vlerëson dhe verifikon implikimet e mundshme fiskale, të drejtpërdrejta ose jo, mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, buxhetin e shtetit ose që ndryshon në çfarëdolloj mënyre mbështetjen financiare.”;

b) pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Çdo ndryshim ose transferim i kontratës së koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që merr përsipër risqe fiskale, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoriteti kontraktues.”.

17. Pikat 9 dhe 10, të nenit 25, ndryshohen si më poshtë vijon:

“9. Në rastin kur operatori ka përfituar të drejtën për kompensim, për propozimin e pakërkuar, kompensimi do t'i llogaritet operatorit ose bashkimit të përkohshëm të operatorëve ku ai bën pjesë.

10. Në rastet kur dy ose më shumë operatorë kanë përfituar të drejtën për kompensim, për propozimin e pakërkuar të paraqitur bashkërisht, kompensimi nuk i llogaritet secilit prej tyre, nëse marrin pjesë individualisht në garë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama